

# TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PUNËS

## PËR RATECH sh.p.k.

Në këtë dokument, RATECH sh.p.k. dhe produkteve të ofruara prej tij u referohemi si “RATECH”, “ne”, “yni” dhe “tonat”, kurse individit, personit fizik apo juridik që ka pranuar këtë dokument, si pjesë e një marrëveshjeje kontraktore, i referohemi si “klient”, “ju” dhe “juaji”. Më poshtë, në këtë dokument, “Termave dhe Kushteve të Përgjithshme të Punës” u referohemi si “termat”.

### 1. PËRKUFIZIME

Në të gjithë dokumentat që përbëjnë kontratën mes palëve, fjalët dhe shprehjet në vijim kanë kuptimet që u jepen atyre nga përkufizimet e mëposhtme:

- 1.1. “Cënim i të dhënave personale” është çdo cënim i sigurisë që çon në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin ose shpërndarjen e paautorizuar, aksidentale apo të paligjshme ose aksesin në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara në produktet e ofruara nga RATECH.
- 1.2. “Data e fillimit” është data e nisjes së punimeve, sipas marrëveshjes mes palëve, e cila evidentohet në proces-verbalin e fillimit të punimeve, të nënshkruar nga përfaqësuesit e të dyja palëve ose në komunikimet me shkrim mes tyre.
- 1.3. “Data e hyrjes në fuqi” është data e pranimit të ofertës nga klienti, përkundrejt nënshkrimit, përveçse nëse është parashikuar një datë tjetër e hyrjes në fuqi me marrëveshje mes palëve.
- 1.4. “Data e përfundimit” është data e përfundimit të punimeve, e cila evidentohet në proces-verbalin e dorëzimit të punimeve.
- 1.5. “Ditë” ka kuptimin e ditëve kalendarike.
- 1.6. “Dorëzimet” janë produktet e procesit të projektimit dhe instalimit që duhet t’i kalohen klientit nga RATECH. Këto përfshijnë projekte, studime, të dhëna, raporte, rekomandime, modele, manuale, vlerësime, formularë, rishikime, programe, konfigurime të aplikacionit, etj, të përgatitura nga personeli i RATECH gjatë kryerjes së shërbimeve për Klientin.
- 1.7. “Forcë madhore” është çdo ngjarje që ndodh jashtë kontrollit të arsyeshëm të palëve, që nuk mund të parashikohet prej tyre dhe që nuk përbën neglizhencë nga ana e tyre. Këtu bëjnë pjesë kufizimet e vendosura nga organet shtetërore, lufrat, zjarret, tërmetet, përmytjet, embargot, epidemitë, protestat, etj.
- 1.8. “Grafiku i punimeve” janë afatet e përcaktuara për dorëzimet, ekzekutimin dhe përfundimin e punimeve.

1.9. “Inxhinieri i punimeve” është personi i caktuar nga Klienti për të vepruar si mbikëqyrës për qëllimet e kontratës mes palëve.

1.10. “Kontratë” është çdo marrëveshje me shkrim për furnizimin, shpërndarjen ose shitjen e çdo produkti, e arritur mes RATECH dhe klientit ose çfarëdo urdhër blerjeje që lëshohet nga klienti dhe pranohet nga RATECH. Kontrata mund të përfshijë këto terma, letrën e ofertës dhe çdo dokument apo komunikim tjetër mes shkrim, në të cilat shprehet vullneti i palëve.

1.11. “Menaxheri i projektit” është personi i caktuar nga ne për të planifikuar, ekzekutuar dhe drejtuar punimet, si dhe për të mbajtur kontaktin me klientin.

1.12. “Ndryshim” është çdo ndryshim që bëhet në vizatime, specifikime teknike, grafikun e punimeve, produkte, etj, të cilat kërkohen nga klienti ose sugjerohen nga RATECH dhe miratohen nga klienti. Ndryshimet hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre nga të dyja palët.

1.13. “Operatori” është individ i autorizuar (përdoruesi) që përdor një sistem për qëllimin e tij të synuar.

1.14. “Pajisjet tona” janë të gjitha aparatet, makineritë, mjetet dhe sendet e tjera të nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, si dhe për riparimin e ndonjë defekti eventual.

1.15. “Produkt” është çdo pajisje, përfshirë softuer, që ofrohet nga RATECH, si pjesë e shërbimeve të tij të instalimit dhe integritit.

“Punimet” janë akvitetet profesionale, që janë në fushën e veprimtarisë së RATECH, të cilat duhet të kryhen për të përmbushur qëllimin e kontratës.

1.16. “Sistem” është çdo tërësi pajisjesh elektrike, elektronike ose të tjera të dizajnuara, të ndërtuara ose të përshtatura për furnizimin me energji elektrike, ndriçimin, mbikëqyrjen video, kontrollin e hyrjes, zbulimin e hyrjeve të padëshiruara, alarmet e zjarrit dhe funksione të tjera të lidhura me energjinë elektrike, ndriçimin dhe sigurinë.

1.17. “Situacioni” është dokumenti i hartuar nga drejtuesi i projektit dhe i miratuar nga inxhinieri i punimeve ose përfaqësuesi i klientit, i cili tregon produktet e përdorura deri në momentin e hartimit të tij, sasisë dhe kostot përkatëse. Situacioni mund të jetë periodik, me kërkesë ose përfundimtar. Situacioni i bashkëlidhen librezat e masave, si dhe çdo dokumentacion tjetër i kërkuar nga legjislativi në fuqi.

1.18. “Specifikimet” janë të dhënat teknike të sistemit dhe të produkteve, siç janë dhënë në projekt dhe përfshirë në kontratë.

1.19. “Shërbime të instalimit dhe integritet” (“shërbime”) është veprimtaria e projektimit, vendosjes së pajisjeve dhe programeve për të krijuar një sistem dhe integrimi i disa sistemeve, në mënyrë që ata të funksionojnë së bashku për qëllimin e synuar, si edhe mirëmbajtja e këtyre.

1.20. “Vizatimet” janë paraqitjet grafike dhe me softuerë profesionalë të projektit.

1.21. “Objekti/Kantieri” nënkupton vendin ku do të kryhen punimet ose vende të tjera që mund të përcaktohen në kontratë si pjesë përbërëse e vendit ku do të kryhen punimet.

## 2. BAZA LIGJORE

2.1. Këto terma janë hartuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar, në veçanti dispozitat e Kodit Civil, dhe rregullohen nga legjislacioni shqiptar. Për interpretimin dhe zbatimin e kontratës mes jush dhe RATECH, si dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin mes palëve, zbatohet legjislacioni shqiptar.

2.2. Këto terma bazohen në pranimin e detyrimeve të dyanshme dhe reciproke të palëve ndaj njëra-tjetrës. Palët e përcaktojnë lirisht përmbajtjen e detyrimeve të tyre, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe, në këtë rast, detyrimet e përcaktuara në këto terma marrin fuqinë e ligjit për palët.

## 3. INTERPRETIMI

3.1. Kontrata mes palëve interpretohet duke mbajtur parasysh qëllimin e palëve siç është shprehur në këtë dokument dhe dokumenta të tjerë që janë pjesë përbërëse e saj.

3.2. Secili nga kushtet e kontratës interpretohet në mënyrën që mundëson realizimin e objektit të marrëdhënies kontraktore.

3.3. Titujt e klauzolave të këtyre termave nuk ndikojnë në interpretimin e tyre.

3.4. Në këto terma dhe në dokumentat e tjerë që përbëjnë kontratën mes palëve:

3.4.1. njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas, me përjashtim të rastit kur nga konteksti del plotësisht e qartë që zbatohet vetëm njëjësi ose shumësi, sipas rastit.

3.4.2. afatet në ditë interpretohen si afate në ditë kalendarike. Dita, në të cilën ndodh ngjarja që shkakton fillimin e afatit, nuk llogaritet në afat.

3.5. Fjalët e përdorura në këto terma dhe në dokumentat e tjerë që përbëjnë kontratën mes palëve kanë, sipas radhës, këtë kuptim:

3.5.1. kuptimin e dhënë nga përkufizimet e këtyre termave.

3.5.2. kuptimin e dhënë nga ligji dhe praktika gjyqësore.

3.5.3. kuptimin e tyre të përgjithshëm si fjalë shqipe.

## 4. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

4.1. Këto terma rregullojnë furnizimin me produkte dhe ofrimin e shërbimeve që lidhen me sisteme elektrike, ndriçimi dhe siguri që futen në fushën e ekspertizës së RATECH, si dhe kryerjen e veprimeve përkatëse dhe bashkëpunimin nga klienti.

4.2. Këto terma janë pjesë e një kontrate për furnizimin me produkte dhe/ose kryerjen e shërbimeve dhe detajojnë marrëdhënien mes RATECH dhe klientit.

4.3. Këto terma zbatohen për çdo produkt ose shërbim që i kërkohet RATECH të ofrojë, për sa kohë që asnjë parashikim i ndryshëm nuk përmbahet në ndonjë akt ligjor apo nënligjor. Detajet që lidhen me qëllimin e shërbimeve apo punimeve dhe specifikimet teknike të produkteve do të përcaktohen në letrën e ofertës.

4.4. Termat e përgjithshme të punës së klientit nuk përbëjnë objekt marrëveshjeje mes palëve. Ky rregull zbatohet edhe kur RATECH nuk kundërshton në mënyrë të shprehur termat e përgjithshme të punës së klientit.

4.5. Pranimi i letrës së ofertës, pagesa nga ana e klientit për produktet e shërbimet tona ose përdorimi i këtyre produkteve e shërbimeve nënkupton pranim të pakufizuar të këtyre termave, ashtu siç përmbahen në këtë dokument, përveçse nëse janë ndryshuar me shkrim dhe aprovuar nga të dyja palët. Përgjegjësia për të na njoftuar me shkrim që nuk jeni dakord me ndonjë nga kushtet e përcaktuara këtu është e juaja.

4.6. Klienti pranon që shërbimet e parashikuara në kontratën me RATECH janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për kërkesat e tij. Ju keni të drejtë të kërkonit produkte, shërbime ose punime shtesë në çdo kohë që e gjykoni të domosdoshme dhe ne do t'i ofrojmë ato me tarifën e zbatueshme në kohën e kërkesës.

4.7. Klienti pranon që ka pranuar produktet dhe shërbimet tona pasi ka kryer konsultimet e nevojshme me punonjës të specializuar apo konsulentë të jashtëm dhe që nuk është mbështetur vetëm në rekomandimet tona.

4.8. Ofrimi i shërbimit nuk fillon deri sa ju të na siguronit informacione të plota të kontaktit, përfshirë emrat e personave të kontaktit, numrat e telefonit dhe adresat e postës elektronike.

4.9. Për qëllimet e kontratës mes jush dhe RATECH, të gjitha korrespondencat me shkrim i adresohen RATECH sh.p.k, Rruga e Kavajës, Kompleksi Delijorgji, Godina. D, Hyrja. A, Tiranë, Shqipëri, +355 (0) 67 20 20 224, [sales@ratech.al](mailto:sales@ratech.al).

## 5. DEKLARIMET

5.1. RATECH përfaqëson dhe deklaron se veprimtaria e tij në të gjitha fushat e ekspertizës bazohet në legjislacionin në fuqi për rregullimin e aktiviteteve profesionale dhe tregëtare. Gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës, RATECH plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe është i pajisur me të gjithë dokumentacionin që e lejon atë të përmbushë objektin e kontratës.

5.2. RATECH përfaqëson dhe deklaron që të gjithë produktet e ofruara prej tij kanë deklaratat e

konformitetit me standardet më të avancuara ndërkombëtare dhe të gjitha shërbimet ofrohen në mënyrë profesionale, në përputhje me metodat dhe praktikatat më të mira të industrisë.

5.3. RATECH përfaqëson dhe garanton që punonjësit e saj, përfaqësuesit dhe agjentët kanë në çdo kohë aftësinë, mundësinë dhe përvojën e nevojshme për të kryer në mënyrë profesionale shërbimet e përshkruara në kontratë. Për më tepër, RATECH garanton personel në numër të mjaftueshëm dhe në kohën e duhur për të kryer shërbimet sipas kushteve të kontratës.

5.4. RATECH përfaqëson dhe garanton që shërbimet e ofruara do të rezultojnë në një sistem që operon brenda mjedisit të klientit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kontratë.

5.5. RATECH përfaqëson dhe garanton që produktet apo sistemet e dorëzuara tek klienti nuk përmbajnë asnjë karakteristikë mbrojtëse, *kill code* të programuar në kalendar, *computer worm*, *Trojan horse*, *bug*, *collector* ose *tailgate* apo çdo program tjetër të dizajnuar për të penguar përdorimin e vetë sistemit apo përdorimin e çdo sistemi apo programi tjetër të lidhur me të, përfshirë sistemet operative në përdorim të klientit. RATECH garanton se nuk do të dëmtojë, në asnjë mënyrë, funksionimin e ndonjë softueri apo sistemi të klientit.

5.6. Punimet do të konsiderohen si vepra të kompletuara, të gatshme për përdorim dhe do të bëhen pronë ekskluzive e klientit pas pagimit të të gjitha faturave.

5.7. RATECH përfaqëson dhe deklaron që respekton dhe detyron punonjësit e tij dhe personat e tjerë të interesuar të respektojnë rregullat e zbatueshme për parandalimin e aksidenteve dhe sigurinë në punë.

5.8. RATECH përfaqëson dhe garanton që shërbimet kryhen vetëm nga persona që kanë kualifikimet e përshtatshme profesionale dhe teknike për t'i kryer ato.

5.9. RATECH përfaqëson dhe garanton që zbaton procedurë të përshtatshme për të garantuar formimin e vazhduar profesional të punonjësve të tij dhe informimin e tyre për legjislacionin e zbatueshëm në çdo kohë.

5.10. RATECH përfaqëson dhe garanton që, nëse punimet do të kryhen në një kantier të përbashkët me ofrues të tjerë të shërbimeve, do të zbatohet rregullat e vendosura në kantier nga klienti dhe do të bashkëpunojë me ofruesit e tjerë të shërbimeve për respektimin e specifikimeve dhe afatit të punimeve.

5.11. RATECH përfaqëson dhe garanton që nuk do të kontraktojë palë të treta për kryerjen e punimeve ose ofrimin e shërbimeve, përveçse nëse kjo parashikohet shprehimisht në kontratën mes palëve. Ky paragraf nuk zbatohet për marrëdhëniet e RATECH me furnitorët e tij.

## 6. MARRËDHËNIA E PAVARUR KONTRAKTORE

6.1. Klienti dhe RATECH, në çdo kohë gjatë kontratës, janë dhe mbeten palë kontraktore të pavarura. Asnjë në këto terma apo dokumentat e tjerë që përbëjnë kontratën mes palëve nuk interpretohet se krijon partneritet apo ndërmarrje të përbashkëta. Asnjë nga palët nuk do ta prezantojë veten para të tjerëve përveçse si një palë kontraktore e pavaruar e palës tjetër. Asnjë nga palët, punonjësit apo përfaqësuesit e tyre nuk janë të autorizuar të përfaqësojnë apo të marrin angazhime në emër të palës tjetër.

6.2. Asnjë nga palët nuk ka të drejtë të nxjerrë njoftime për shtyp ose të përfshijë në aktivitete të tjera promovuese njoftime që tregojnë identitetin e palës tjetër, pa marrë më parë miratimin e saj me shkrim për ta bërë këtë. Sidoqoftë, RATECH ka të drejtë t'i referohet emrit të klientit në materiale promovuese pa ndonjë përshkrim të projektit ose të kushteve të angazhimit të përcaktuara më poshtë ose në dokumentat e tjerë që përbëjnë kontratën mes palëve.

## 7. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

Me pranimin e këtyre termave, ju pranoni dhe jeni dakord me sa vijon:

7.1. RATECH është në biznesin e shitjes, instalimit, integritit dhe mirëmbajtjes edhe të sistemeve elektronike të sigurisë. Ne nuk jemi siguroes. Pajisjet dhe shërbimet tona nuk zëvendësojnë sigurimin e duhur të pronës, jetës, shëndetit apo përgjegjësisë. Shërbimet e ofruara nga RATECH nuk realizojnë në vetvete shmangien ose parandalimin e humbjes ose dëmtimit të pronës, dëmtimit ose humbjes së jetës dhe shëndetit të personave në ambientet ku ofrohen shërbimet apo në vende të tjera.

7.2. RATECH nuk është përgjegjës për asnjë humbje apo dëm që i ka ardhur klientit si pasojë e vonësës ose dështimit për t'u përgjigjur ndaj një alarmi të dhënë nga sistemi nga ana e policisë, shërbimit të zjarrfikseve apo agjenci të tjera.

7.3. Duke pranuar këto terma, ju hiqni dorë nga të gjitha pretendimet për humbje, dëmtim, plagosje ose vdekje ndaj RATECH, punonjësve, agjentëve dhe nënkontraktorëve të tij.

## 8. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

8.1. Përgjegjësia për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të personave që preken nga sistemet e sigurisë i takon klientit. RATECH nuk është përgjegjës, vetëm apo solidarisht me klientin, për asnjë cënim të të dhënave personale, që ka ardhur si pasojë e përdorimit të duhur ose jo të sistemit të instaluar apo integruar prej tij.

8.2. RATECH nuk ka përgjegjësi për të informuar klientin lidhur me legjislacionin e zbatueshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Nëse RATECH i jep informacion klientit për këtë çështje, RATECH nuk

mban asnjë përgjegjësi për cilësinë apo plotësinë e këtij informacioni.

## 9. DETYRIMI PËR DËMSPËRBLIM

9.1. Qëllimi i kontratës është që ju të jeni përfituesi i vetëm i shërbimeve të ofruara sipas marrëveshjes dhe që nuk ka palë të treta përfituese të shërbimit, përveçse nëse këto janë përmendur shprehimisht në kontratë.

9.2. Ju bini dakord të na dëmshpërbleni për çdo kosto, humbje apo dëm, duke përfshirë tarifat ligjore, administrative, gjyqësore dhe të avokatit, si dhe çdo shpenzim tjetër të arsyeshëm të kryer nga ana jonë për shkak të kërkesave, pretendimeve, faturimeve ose padive të ngritura nga palë të treta dhe të lidhura me objektin e kontratës.

9.3. Paragrafi 9.2. zbatohet njëloj edhe në rastin kur kontrata përmban një palë të tretë përfituese.

## 10. LETRA E OFERTËS

10.1. Letra e ofertës përbëhet nga oferta financiare dhe propozimi teknik.

10.2. Propozimi teknik përfshin përgjigjet teknike dhe tregtare ndaj kërkesave të klientit, të paraqitura në mënyrë të strukturuar dhe standarde, për të mundësuar një vlerësim të drejtë nga ana e tij. Një propozim i plotë teknik përfshin kryerjen e të gjithë punës, mbikëqyrjes, ofrimin e të gjitha materialeve, mjeteve, programeve kompjuterike dhe pajisjeve të nevojshme për të përfunduar të gjitha punimet, siç përcaktohet në letërën e ofertës.

10.3. Propozimi teknik përmban afatin dhe grafikun e punimeve. Afati mund të përcaktohet me datë ose mund të përcaktohet në bazë të ndonjë ngjarjeje që pritet të ndodhë ose në bazë të njoftimit të ndërsjellë të palëve.

10.4. Oferta financiare përmban kushtet e pagesës. Kushtet e zakonshme të pagesës për produktet dhe shërbimet e ofruara nga RATECH janë: 25% parapagim për të konfirmuar porosinë, 65 % para instalimit dhe 10% pas dorëzimit. Marrëveshja e palëve për kushte të ndryshme pagese duhet të pasqyrohet qartë në letërën e ofertës.

10.5. Kur kërkohet nga klienti apo nga natyra e oferets apo punimeve të përfshira, letra e ofertës përmban edhe certifikatat e sigurisë së produkteve që janë objekt furnizimi.

10.6. Letra e ofertës, e pranuar dhe e nënshkruar nga klienti, është pjesë integrale e marrëveshjes kontraktore.

10.7. Duke pranuar ofertën, klienti pranon që propozimi teknik i parashikuar në ofertë është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për kërkesat e tij. Klienti ka të drejtë të kërkojë shërbime shtesë në çdo kohë dhe ne do t'i prezantojmë ato në një letër të re oferte, e cila, pas pranimit nga klienti, do të bëhet gjithashtu pjesë integrale e marrëveshjes.

## 11. EKZEKUTIMI I PUNIMEVE

11.1. RATECH do të kryejë të gjitha shërbimet dhe punimet që përshkruhen në ofertë, si dhe ato që nuk përmenden shprehimisht në propozimin teknik, por që janë qartazi të nevojshme për ekzekutimin e duhur të shërbimit. Propozimi teknik nuk ka për qëllim të listojë ose të përshkruajë çdo detaj dhe veçori të punës. Rezultati përfundimtar i punës së RATECH do të jetë një sistem plotësisht funksional dhe operatorë të trajnuar në vendet e përcaktuara, përveçse kur marrëveshja mes palëve parashikon ndryshe.

11.2. Secila palë do të sigurojë personelin për të plotësuar rolet, përgjegjësitë, kërkesat e përcaktuara të aftësi dhe angazhimet kohore të përshkruara në secilin dokument në fuqi. Në mënyrë të posaçme, ne do të caktojmë një menaxher të projektit, kurse klienti do të caktojë një inxhinier të punimeve ose një përfaqësues të tij. Përfaqësuesi i inxhinierit të punimeve mund të caktohet nga inxhinieri i punimeve për të ndjekur të gjitha punimet ose një pjesë të tyre. Njoftimi për caktimin e këtij personi bëhet me shkrim dhe vetëm pas këtij njoftimi ne do të vazhdojmë komunikimin me të

11.3. Secila palë do të vendosë në dispozicion të gjitha materialet që nevojiten për kryerjen e të gjitha zërave të punës, sipas objektit të kontratës.

11.4. RATECH do t'i kryejë punimet duke përdorur materialet, pajisjet, mjetet, makinat, makineritë dhe personelin e tij, përveçse kur parashikohet ndryshe me marrëveshje të palëve. Kur është e aplikueshme, këto duhet të marin miratimin e inxhinierit të klientit përpara se të hyjnë ose të përdoren në objekt. Materialet dhe pajisjet ruhen dhe magazinohen në objekt ose në ambiente të tjera të klientit, në përputhje me përcaktimet e këtij të fundit.

11.5. Klienti siguron furnizimin me energji elektrike për realizimin e punimeve brenda kantierit. Në rastin kur mungon energjia elektrike nga rrjeti, klienti i siguron burimet alternative të energjisë me shpenzimet e veta.

11.6. RATECH do t'i paraqesë klientit raporte të statusit të projektit sipas kërkesës.

11.7. RATECH do të mbajë të dhëna të sakta, raporte dhe regjistra të të gjitha çështjeve dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me punimet, projektin dhe marrëveshjen kontraktore. Këto do të jenë të disponueshme për inspektim nga klienti në çdo kohë gjatë vazhdimit të marrëveshjes dhe do të mbeten pronë e Klientit.

11.8. Klienti pranon të sigurojë pajisjet, të dhënat, informacionin, hapësirën e punës, furnizimet dhe personelin e identifikuar në propozimin teknik, si dhe të sigurojë informacionin e kërkuar dhe të marrë vendime në një mënyrë të shpejtë dhe në kohë. akses në objektin

11.9. Nëse klienti ose RATECH dëshirojnë të ndryshojnë ose të plotësojnë punimet e përcaktuara në propozimin teknik, pala kërkuese i kërkon këto me shkrim, si një ndryshim në propozimin teknik dhe financiar (një letër oferte shtesë). Në mënyrë që oferta shtesë të bëhet efektive dhe para çdo pune shtesë që



kryhet, RATECH dhe klienti i nënshkruajnë ndryshimet ose plotësimet siç përcaktohen në ofertën shtesë (p.sh. orari, buxheti, dorëzimet dhe kriteret e pranimit) .

11.10. Kur projekti ka dorëzime, RATECH dorëzon çdo dorëzim të përfunduar në datën e përcaktuar në propozimin teknik. Pas dorëzimit, klienti ka 3 ditë pune për të pranuar ose refuzuar dorëzimin, bazuar në kriteret e pranimit të përcaktuara për atë dorëzim. Pranimi do të konfirmohet me nënshkrimin e klientit.

11.11. Refuzimi bëhet me një njoftim me shkrim që specifikon mangësitë. RATECH korrigjon mangësitë jo më vonë se 5 ditë pune nga data e njoftimit. Pas paraqitjes së dorëzimit të korrigjuar, klienti ka 3 ditë pune kohë për të pranuar ose refuzuar dorëzimin, bazuar në kriteret e pranimit për atë dorëzim. Nëse klienti e refuzon dorëzimin edhe një herë, atëherë atij i lind e drejta të zgjidhë marrëveshjen. Nëse klienti nuk e refuzon dorëzimin brenda 3 ditëve si më lart, konsiderohet se ai e ka pranuar këtë dorëzim duke filluar nga disa e nesërme pas kalimit të afatit 3 ditor.

11.12. Në rastet kur propozimi teknik kërkon që të hyjmë në ambjentet tuaja, ne do të tregojmë të gjithë kujdesin e arsyeshëm për këto ambjente. Ne nuk do të lejojmë hyrjen e personave të panjohur dhe as nuk do t'i lëmë ato pa ruajtje. Ne nuk kemi detyrim të riparojmë, lyejmë apo rregullojmë në ndonjë mënyrë tjetër sipërfaqet apo vendet në të cilat janë vendosur kabllimet apo pajisjet. Në fund të çdo dite pune dhe para dorëzimit të punimeve, ne do të bëjmë pastrimin e objektit apo ambjenteve nga mbeturinat e krijuara si rezultat i veprimtarisë sonë.

## 12. TESTIMI, PRANIMI DHE DORËZIMI

12.1. Pas përfundimit të instalimit, RATECH trajnon personat e përcaktuar nga klienti për operimin e sistemit. Tre orë trajnim ofrohen si pjesë e paketës së instalimit. Trajnimi përfshin operimin e sistemit dhe zgjidhjen e problemeve bazike të sistemit.

12.2. Përpara pranimit të sistemit, RATECH kryen testimin e plotë operacional dhe verifikon që të gjithë pjesët e sistemit funksionojnë sipas specifikimeve teknike.

12.3. Klienti ka të drejtë të jetë i pranishëm në testimet e kryera. Në përfundim të tyre, ai mund të bëjë vërejtje e kërkesa me shkrim.

12.4. Për rastet e integritetit të sistemeve, si pjesë e pranimit të tyre, RATECH përgatit vizatimet e punimeve në AutoCad, të cilat tregojnë vendndodhjen e saktë të çdo pajisjeje, kabllimin me kode me ngjyra, etj.

12.5. Përpara dorëzimit, klienti mund të kryejë inspektime të materialeve dhe të punimeve, për të verifikuar respektimin e kushteve të kontratës, standardet e garantimit të cilësisë dhe respektimin e legjislacionit në fuqi.

12.6. Dorëzimi i sistemit do të bëhet me shkrim, nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit, të nënshkruar nga

punonjësi i autorizuar i RATECH që bën dorëzimin dhe personi i autorizuar nga klienti.

12.7. Me dorëzimin e sistemit, RATECH dorëzon edhe manualët e instalimit dhe përdorimit të të gjitha pajisjeve të instaluara, si edhe çdo dokumentacion tjetër të krijuar nga prodhuesi që ndihmon në operimin e mirë të sistemit.

## 13. PAGESA

13.1. Klienti merr përsipër pagesën e vlerës së kontratës dhe të çdo punimi të kryer me kërkesën e tij.

13.2. Kushtet e pagesës përcaktohen me marrëveshje mes palëve.

13.3. Vlera e kontratës mbështetet në ofertën financiare dhe kostot e vlerësuara të punimeve në datën e hyrjes në fuqi të kontratës, si dhe në ndryshimet e bëra me marrëveshje të palëve bazuar në këto terma.

13.4. Me përfundimin e punimeve, nga përfaqësuesit e të dy palëve do të bëhen kontrollet përkatëse në objekt duke rakorduar punimet faktike të kryera. Referencë për likuidimin do të jenë proces-verbalet e dorëzimit të produkteve, situacionet e punimeve dhe faturat tatimore të pranuar nga klienti.

## 14. NDRYSHIMI I MARRËVESHJES

Marrëveshja mes jush dhe RATECH mund të ndryshohet vetëm me shkrim. Ndryshimet në kushtet e këtyre termave mund të kenë vlerë vetëm nëse janë nënshkruar nga RATECH në një letër oferte dhe janë miratuar nga ju. Këto terma do të zbatohen edhe për çdo ndryshim që bëhet në ofertën financiare dhe propozimin teknik drejtuar klientit. Kjo marrëveshje nuk mund të ndryshojë, përveçse me një marrëveshje të re me shkrim të palëve. Asnjëra nga palët nuk mund të caktojë, transferojë, ngarkojë, autorizojë ose të tregtojë apo disponojë në mënyra të tjera të drejtat ose detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshjeje.

## 15. ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

15.1. Klienti mund ta zgjidhë marrëveshjen me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar RATECH në këto raste:

15.1.1. nëse RATECH është në gjendje paaftësie paguese ose ka filluar procedurat e likuidimit ose falimentit;

15.1.2. nëse RATECH është subjekt i një urdhri ose vendimi për administrimin, likuidimin ose prishjen e shoqërisë;

15.1.3. në rastet e forcës madhore që e shtyjnë datën e përfundimit të punimeve për më shumë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë;

15.1.4. nëse, gjatë zbatimit të projektit, RATECH bën devijime nga standardet teknike apo cilësia e materialeve të përdorura, të cilat nuk janë aprovuar nga klienti dhe nuk janë rregulluar nga RATECH brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim nga klienti me kërkesën për riparim;

15.1.5. nëse RATECH braktis punimet për më shumë se 60 ditë ose demonstroi në mënyra të tjera qëllimin e tij për të mos vazhduar me përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje.

15.2. Në rast të zgjidhjes së marrëveshjes nga klienti sipas paragrafit 14.1, RATECH ka të drejtë të marrë materialet e veta dhe sendet që mund të shpëputen nga objekti, si edhe të kërkojë pagimin e kostove të nevojshme dhe të arsyeshme deri në atë moment.

15.3. Klienti mund të tërhiqet nga marrëveshja, edhe kur kanë filluar punimet, me kusht që ta kompensojë RATECH për kostot e deriatëhershme, për punimet e bëra dhe për fitimin e munguar.

15.4. Kur marrëveshja zgjidhet sepse punimet janë bërë të pamundura si pasojë e një shkakut që nuk mund t'i atribuohet asnjërës palë, klienti paguan pjesën e punimeve të kryera në kufijtë brenda të cilëve është e dobishme për të, në përpjesëtim me vlerën e të gjithë sistemit.

15.5. RATECH mund ta zgjidhë marrëveshjen me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar klientit në këto raste:

15.5.1. nëse klienti është në gjendje paaftësie paguese ose ka filluar procedurat e likuidimit ose falimentit;

15.5.2. nëse klienti është subjekt i një urdhri ose vendimi për administrimin, likuidimin ose prishjen e shoqërisë;

15.5.3. në rastet e forcës madhore që e shtyjnë datën e përfundimit të punimeve për më shumë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë;

15.5.4. nëse, gjatë zbatimit të projektit, klienti kërkon ndryshime në specifikimet teknike apo produktet e përdorura dhe instalimi i sistemit nuk mund të vazhdojë pa u miratuar me shkrim këto dhe ndryshimet përkatëse në ofertën financiare;

15.5.5. nëse klienti kërkon ndërprerjen e punimeve për më shumë se 60 ditë ose demonstroi në mënyra të tjera qëllimin e tij për të mos vazhduar me përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje.

15.6. Në rast të zgjidhjes së marrëveshjes nga RATECH sipas paragrafit 14.5, RATECH ka të drejtë të marrë materialet e veta dhe sendet që mund të shpëputen, si edhe të kërkojë pagimin e kostove të nevojshme dhe të arsyeshme deri në atë moment.

## 16. PRONËSIA INTELEKTUALE

16.1. RATECH do të mbajë pronësinë e të gjitha metodave, ideve, koncepteve, sekreteve të biznesit, dokumentacionit që lidhet me programet kompjuterike, të çdo pronësie tjetër intelektuale apo informacioni që i përkiste RATECH para nënshkrimit të marrëveshjes, si dhe të aftësive dhe ekspertizës që punonjësit e tij kanë fituar gjatë punës për klientin.

## 17. DISPOZITA TË FUNDIT

17.1. Palët respektojnë konfidencialitetin e informacioneve që lidhen me palën tjetër.

17.2. Palët mund ta përdorin informacionin konfidencial të palës tjetër vetëm për qëllimet e kësaj kontrate dhe mund t'ua japin këtë informacion punonjësve të tyre, drejtorëve, nënkontraktorëve, agjentëve, furnizuesve, këshilltarëve profesionalë dhe shoqërive të lidhura vetëm në masën që është e nevojshme për arritjen e qëllimit të kësaj marrëveshjeje.

17.3. Përveç se kur parashikohet ndryshe shprehimisht me marrëveshje mes palëve, çdo njoftim ose komunikim mes palëve do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet me postë të regjistruar ose në adresat elektronike që palët ia kanë njoftuar me shkrim njëra-tjetrës.

17.4. Të gjitha komunikimet midis palëve do të jenë në gjuhën shqipe.

17.5. Përpunimi i të dhënave (sipas ligjit nr. 9887, 10.3.2008) bëhet në mënyrë të automatizuar dhe vetëm për qëllim të administrimit të marrëdhënieve tregtare. Të dhënat përpunohen nga RATECH, titullari i përpunimit, dhe nuk u shpërndahen të tretëve. Klienti ka në çdo kohë të drejtë të kërkojë ndryshimin ose fshirjen e të dhënave të tij apo të kundërshtojë përdorimin e tyre për dërgimin e informacioneve dhe materialeve tregtare. Kjo e drejtë ushtrohet nëpërmjet komunikimit me shkrim.